

LIGJ
Nr. 75/2016

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARISIT, NË KUADËR TË
KONVENTËS KUADËR TË KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR NDRYSHIMET
KLIMATIKE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja e Parisit, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike, bërë në Paris më 12.12.2015, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 14.7.2016

Shpallur me dekreten nr. 9710, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJA E PARISIT

Palët e kësaj Marrëveshjeje,

duke qenë Palë të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës, më poshtë e referuar si “Konventa”;

në zbatim të Platformës Durban për Veprim të Përmirësuar, të krijuar nga vendimi 1/CP.17 të Konferencës së Palëve për Konventën në sesionin e saj të shtatëmbëdhjetë;

në ndjekje të objektivit të Konventës dhe e udhëhequr nga parimet e saj, duke përfshirë parimin e barazisë dhe përgjegjësitë e përbashkëta, por përgjegjësitë/kapacitetet e diferencuara përkatëse në bazë të rrethanave të ndryshme kombëtare;

duke njohur nevojën për një reagim efektiv dhe progresiv ndaj kërcënimit urgjent të ndryshimit të klimës në bazë të njohurive shkencore më të mira të disponueshme;

duke njohur, gjithashtu, nevojat specifike dhe rrethanat e veçanta të Palëve, të cilat janë vende në zhvillim, veçanërisht ato që janë vulnerabël ndaj efekteve negative të ndryshimit të klimës, siç parashikohet në Konventë;

duke marrë në konsideratë të plotë nevojat specifike dhe situatat e veçanta të vendeve më pak të zhvilluara në lidhje me financimin dhe transferimin e teknologjisë;

duke pranuar që Palët mund të ndikohen jo vetëm nga ndryshimi i klimës, por, gjithashtu, nga ndikimet e masave të marra në reagim të saj;

duke theksuar marrëdhënien e brendshme që veprimet, reagimet dhe ndikimet e ndryshimit të klimës kanë me aksesin e drejtë ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe çrrënjosjen e varfërisë;

duke njohur prioritetin thelbësor të ruajtjes së sigurisë ushqimore dhe për t'i dhënë fund urisë, dhe vulnerabilitetet e veçanta të sistemeve të prodhimit të ushqimit ndaj ndikimeve negative të ndryshimit të klimës;

duke marrë parasysh kërkesat e një tranzicioni të drejtë të krahut/forcës të/së punës dhe krijimit të një pune të denjë dhe profesioneve cilësorë në përputhje me prioritetet e zhvillimit të përcaktuara në nivel kombëtar;

duke pranuar se ndryshimi i klimës është një shqetësim i përbashkët i njerëzimit, Palët, kur marrin masa për të trajtuar ndryshimin e klimës, duhet të respektojnë, promovojnë dhe të marrin

në konsideratë detyrimet e tyre përkatëse për të drejtat e njeriut, të drejtën për shëndet, të drejtat e popullatave indigjene, komunitetet lokale, emigrantët, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat në situata vulnerabël dhe të drejtën për zhvillim, si edhe barazinë gjinore, fuqizimin e gruas dhe barazinë e brezave;

duke njohur rëndësinë e konservimit dhe të përmirësimit, si të jetë e përshtatshme, të vaskave dhe rezervuarëve të gazeve serrë të referuara në Konventë;

duke vënë në dukje rëndësinë e sigurimit të integritetit të të gjitha ekosistemeve, përfshirë oqeanet dhe mbrojtjen e biodiversitetit, të njohura nga disa kultura, si Nëna Tokë dhe duke theksuar rëndësinë për disa, të konceptit “drejtësia e klimës”, kur merren masa për të trajtuar ndryshimin e klimës;

duke afirmuar rëndësinë e arsimit/edukimit, trajnimit, ndërgjegjësimit të publikut, pjesë-marrjes së publikut, aksesin e publikut në informacion dhe bashkëpunimin në të gjitha nivelet mbi çështjet e trajtuara në këtë Marrëveshje;

duke njohur rëndësinë e angazhimeve të të gjitha niveleve të grupeve qeveritare dhe të ndryshme të interesit, në përputhje me legjislacionet kombëtare përkatëse të Palëve, në trajtimin e ndryshimit të klimës;

duke pranuar, gjithashtu, që mënyra e jetesës e qëndrueshme dhe modelet e qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit, me Palët të cilat janë vende të zhvilluara që marrin drejtimin, luajnë rol të rëndësishëm në trajtimin e ndryshimit të klimës,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen përkufizimet që përmbahen në nenin 1 të Konventës. Për më tepër:

1. “Konventa” nënkupton Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës, të miratuar në Nju-Jork, më 9 maj 1992.

2. “Konferenca e Palëve” nënkupton Konferencën e Palëve të Konventës.

3. “Palë” nënkupton një Palë në këtë Marrëveshje.

Neni 2

1. Kjo Marrëveshje, në përmirësimin e zbatimit të Konventës, duke përfshirë objektivat, qëllimet e saj për të forcuar reagimin global ndaj kërcënimit të ndryshimit të klimës, në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përpjekjeve për të çrrënjësuar varfërinë, përfshirë, duke:

a) ruajtur rritjen në temperaturën mesatare globale nën 2°C mbi nivelet paraindustriale dhe për të vazhduar përpjekjet për të kufizuar rritjen e temperaturës deri në 1.5°C mbi nivelet paraindustriale, duke pranuar se kjo do të reduktonte ndjeshëm rreziqet dhe ndikimet e ndryshimit të klimës;

b) rritur aftësinë/mundësinë për t’u përshtatur ndaj ndikimeve negative të ndryshimit të klimës dhe për të nxitur aftësitë rikuperuese të klimës dhe zhvillimin e emetimeve të ulëta të emetimeve të gazit serrë, në një mënyrë që nuk rrezikon prodhimin e ushqimit;

c) realizuar flukset financiare në përputhje me një rrugë drejt emetimeve të ulëta të gazit serrë dhe zhvillimit me aftësi rikuperuese ndaj klimës;

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për të reflektuar barazi dhe parimin e përgjegjësisë të përbashkëta, por përgjegjësi dhe kapacitete të diferencuara përkatëse, në bazë të rrethanave të ndryshme kombëtare.

Neni 3

Si kontribute të përcaktuara kombëtare, si reagim global ndaj ndryshimit të klimës, të gjitha Palët do të ndërmarrin dhe do të komunikojnë përpjekje ambicioze, siç janë përcaktuar në nenet 4, 7, 9, 10, 11 dhe 13, me qëllim të arritjes së qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, siç është përcaktuar

në nenin 2. Përpyekjet e të gjitha Palëve do të përfaqësojnë një progres me kalimin e kohës, ndërsa pranojnë nevojën për të mbështetur Palët të cilat janë vende në zhvillim, për zbatimin efektiv të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

1. Në mënyrë që të arrihet qëllimi afatgjatë i temperaturës i përcaktuar në nenin 2, Palët synojnë të arrijnë pikun global të emetimeve të gazit serrë, sa më shpejt që të jetë e mundur, duke pranuar që arritja e pikut do të marrë më shumë kohë për Palët që janë vende në zhvillim dhe për të ndërmarrë reduktime të shpejta më pas, në përputhje me shkencën më të mirë të disponueshme, në mënyrë që të arrihet një ekuilibër ndërmjet emetimeve antropogjene nga burime dhe heqjet nga vaskat e gazeve serrë në gjysmën e dytë të shekullit, në bazë të barazisë dhe në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përpjekjeve për të çrrënjësuar varfërinë.

2. Secila Palë do të përgatisë, do të komu-nikojë dhe do të ruajë kontribute të njëpasnjëshme të përcaktuara në nivel kombëtar që ajo synon të arrijë. Palët do të ndjekin masat zbutëse vendase, me qëllim të arritjes së objektivave të këtyre kontributeve.

3. Kontributet e njëpasnjëshme të përcaktuara në nivel kombëtar, të secilës Palë, do të përfaqësojnë një progres përtej kontributeve të përcaktuara në nivel kombëtar që zhvillohen aktualisht dhe reflektojnë ambicien e saj më të lartë të mundshme, duke reflektuar përgjegjësitë e saj të përbashkëta por të diferencuara dhe aftësitë/mundësitë përkatëse, në bazë të rretha-nave të ndryshme kombëtare.

4. Palët që janë vende të zhvilluara duhet të vazhdojnë të marrin drejtimin duke ndërmarrë synime reduktimi të emetimeve absolute për ekonominë e gjerë. Palët që janë vende në zhvillim duhet të vazhdojnë të rrisin përpjekjet e tyre për zbutje dhe inkurajohen të zhvendosen me kalimin e kohës drejt reduktimeve të emeti-meve për ekonominë e gjerë ose synime kufizimi në bazë të rrethanave të ndryshme kombëtare.

5. Do të sigurohet mbështetje për Palët, të cilat janë vende në zhvillim, për zbatimin e këtij neni, në përputhje me nenet 9, 10 dhe 11, duke pranuar që mbështetja më e madhe për Palët të cilat janë vende në zhvillim, do të lejojë ambicie më të lartë në veprimet e tyre.

6. Vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet në zhvillim që janë ishuj të vegjël (SIDS), mund të përgatisin dhe komunikojnë strategjitë, planet dhe veprimet për zhvillimin e emetimeve të ulëta të gazit serrë, duke reflektuar rrethanat e tyre të veçanta.

7. Bashkëpërfitimet e zbutjes, që vijnë si rezultat nga veprimi i adaptimit dhe planeve të diversifikimit ekonomik të Palëve, mund të kontribuojnë në rezultate zbutjeje sipas këtij neni.

8. Në komunikimin e kontributeve të tyre kombëtare të përcaktuara, të gjitha Palët do të sigurojnë informacionin e nevojshëm për qartësi, transparencë dhe kuptim, në përputhje me vendimin 1/CP.21 dhe çdo vendim përkatës të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

9. Secila Palë do të komunikojë një kontribut të përcaktuar kombëtar, çdo pesë vjet, në përputhje me vendimin 1/CP.21 dhe çdo vendim përkatës të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit dhe të informohen nga rezultatet e analizës globale të referuar në nenin 14.

10. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të marrë në konsideratë afatet kohore të përbashkëta për kontributet e përcaktuara kombëtare në sesionin e saj të parë.

11. Një Palë, në çdo kohë, mund të rregullojë kontributin e saj të përcaktuar kombëtar ekzistues, më qëllim të përmirësimit/rritjes të/së nivelit të saj të ambicies, në përputhje me udhëzimin e miratuar nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

12. Kontributet e përcaktuara kombëtare, të komunikuar nga Palët, do të regjistrohen në një regjistër publik që mbahet nga sekretariati.

13. Palët do të japin llogari për kontributin e tyre të përcaktuar në nivel kombëtar. Në dhënien

e llogarisë për emetimet antropogjene dhe heqjet që korrespondojnë me kontributet e tyre të përcaktuara në nivel kombëtar, Palët do të promovojnë integritet mjedisor, transparencë, saktësi, plotësi, krahasueshmëri dhe përputhshmëri dhe do të garantojnë shmangien e dubliki-mit të dhënies së llogarisë, në përputhje me udhëzimin e miratuar nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

14. Në kontekstin e kontributeve të tyre të përcaktuara në nivel kombëtar, kur njohin dhe zbatojnë veprimet zbutëse në lidhje me emetimet antropogjene dhe heqjet, Palët duhet të marrin në konsideratë metodat ekzistuese dhe udhëzimin sipas Konventës, në bazë të dispozitave të paragrafit 12 të këtij neni.

15. Palët do të marrin në konsideratë, në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, shqetësimet e Palëve, me ekonomitë që janë prekur më shumë nga ndikimet e masave reaguese, veçanërisht Palët që janë vende në zhvillim.

16. Palët, duke përfshirë organizatat rajonale të integritit ekonomik dhe shtetet e tyre anëtare, që kanë arritur një marrëveshje për të vepruar së bashku, sipas paragrafit 2 të këtij neni, do të njoftojnë sekretariatin për termat e marrëveshjes, duke përfshirë nivelin e emetimit të alokuar për secilën Palë, brenda periudhave kohore përkatëse, kur komunikojnë kontributet e tyre të përcaktuara në nivel kombëtar. Sekretariati do të informojë më pas Palët dhe nënshkruesit e Konventës për termat/kushtet e asaj marrëveshjeje.

17. Secila palë e një marrëveshjeje të tillë do të jetë përgjegjëse për nivelet e saj të emetimit, siç është përcaktuar në marrëveshjen e referuar në paragrafin 16 më lart, në përputhje me paragrafët 13 dhe 14 të këtij neni dhe nenet 13 dhe 15.

18. Nëse Palët që veprojnë së bashku, veprojnë kështu në kuadër të dhe së bashku me një organizatë rajonale për integrim ekonomik e cila është Palë e kësaj Marrëveshjeje, secili shtet anëtar i asaj organizate individuale rajonale për integrim ekonomik dhe së bashku me organizatën rajonale për integrim ekonomik, do të jetë përgjegjëse për nivelin e saj të emetimit, siç është përcaktuar në marrëveshjen e komunikuar, sipas paragrafit 16 të këtij neni, në përputhje me paragrafët 13 dhe 14 të këtij neni dhe nenet 13 dhe 15.

19. Të gjitha Palët duhet të përpiqen të formulojnë dhe komunikojnë një strategji zhvillimi afatgjatë për emetime të ulëta të gazit serrë, duke iu referuar nenit 2, duke marrë në konsideratë përgjegjësitë e tyre të përbashkëta, por të diferencuara dhe aftësitë/mundësitë përkatëse në bazë të rrethanave të ndryshme kombëtare.

Neni 5

1. Palët duhet të marrin masa për të ruajtur dhe përmirësuar, si të jetë e përshtatshme, vaskat dhe rezervuarët e gazeve serrë, siç është referuar në nenin 4, paragrafi 1/d të Konventës, duke përfshirë pyjet.

2. Palët inkurajohen që të marrin masa për të zbatuar dhe mbështetur, duke përfshirë pagesat në bazë të rezultateve, kuadrin ekzistues, siç është përcaktuar në udhëzimin përkatës dhe vendimet mbi të cilat tashmë është rënë dakord sipas Konventës, për qasjet politike dhe stimujt pozitivë për aktivitetet në lidhje me reduktimin e emetimeve nga shpyllëzimi dhe degradimi i pyjeve dhe roli i konservimit, menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe përmirësimi i stokeve (rezervave) të karbonit të pyjeve në vendet në zhvillim; dhe qasje politikash alternative, të tilla si qasje zbutjeje dhe adaptimi të përbashkëta për menaxhimin integral dhe të qëndrueshëm të pyjeve, ndërkohë duke afirmuar rëndësinë e stimujve, si të jetë e përshtatshme, përfitime pa karbon që lidhen me këto lloj qasjesh.

Neni 6

1. Palët njohin që disa Palë zgjedhin të ndjekin bashkëpunim vullnetar në zbatimin e kontributeve të tyre të përcaktuara në nivel kombëtar, për të lejuar për ambicie më të lartë në veprimet e tyre, për zbutje dhe adaptim dhe për të nxitur zhvillim të qëndrueshëm dhe integritet mjedisor.

2. Palët, kur angazhohen mbi baza vullnetare në qasje bashkëpunuese, që përfshijnë përdorimin e rezultateve të zbutjes, në nivel ndërkombëtar, të transferuara drejt kontributeve të përcaktuara në nivel kombëtar, do të nxisin zhvillim të qëndrueshëm dhe të sigurojnë integritet mjedisor dhe transparencë, duke përfshirë në qeverisje dhe do të zbatohet llogaridhënie rigoroze për të garantuar, ndër të tjera, shmangien e dublikimit të llogaridhënies, në përputhje me udhëzimin e miratuar nga Konference e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

3. Përdorimi i rezultateve të zbutjes në nivel ndërkombëtar, të transferuara për të arritur kontributet e përcaktuara në nivel kombëtar, sipas Marrëveshjes, do të jetë vullnetare dhe e autorizuar nga Palët pjesëmarrëse.

4. Një mekanizëm për të kontribuar në zbutjen e emetimeve të gazit serrë dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm, krijohet nëpërmjet kësaj, nën autoritetin dhe udhëzimin e Konferencës së Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, për përdorim nga Palët mbi baza vullnetare. Ai do të mbikë-qyret nga një organ i emëruar nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit dhe do të synojë të:

- a) promovojë zbutjen e emetimeve të gazit serrë ndërsa nxit zhvillimin e qëndrueshëm;
- b) stimulojë dhe të lehtësojë pjesëmarrjen në zbutjen e emetimeve të gazit serrë nga publiku dhe subjektet private të autorizuar nga një Palë;
- c) kontribuojë në reduktimin e niveleve të emetimit në Palët pritëse, e cila do të përfitojë nga aktivitetet e zbutjes që rezultojnë në reduktimin e emetimeve që mund të përdoren, gjithashtu, nga një Palë tjetër, për të përmbushur kontributin e saj të përcaktuar në nivel kombëtar; dhe
- d) shpërndajë një zbutje të përgjithshme në emetimet globale.

5. Reduktimet e emetimeve që rrjedhin nga mekanizmi i referuar në paragrafin 4 të këtij neni, nuk do të përdoren për të demonstruar arritje të kontributit të përcaktuar në nivel kombëtar të Palët pritëse, nëse përdoret nga një Palë tjetër për të demonstruar arritjen e kontributit të saj të përcaktuar në nivel kombëtar.

6. Konferenca e Palëve, që shërben si takimi i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të garantojë që një pjesë e të ardhurave, nga aktivitetet nën mekanizmin e referuar në paragrafin 4 të këtij neni, përdoren për të mbuluar shpenzime administrative, si edhe për të asistuar Palët të cilat janë vende në zhvillim, që janë veçanërisht vulnerabël ndaj efekteve negative të ndryshimit të klimës, për të përmbushur kostot e adaptimit.

7. Konferenca e Palëve, që shërben si takimi i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të miratojë rregullat, modalitete dhe procedurat për mekanizmin e referuar në paragrafin 4 të këtij neni në sesionin e saj të parë.

8. Palët njohin rëndësinë e qasjeve të integruara, holistike dhe të balancuara jotregtare që janë të disponueshme për Palët, për të asistuar në zbatimin e kontributeve të tyre të përcaktuara në nivel kombëtar, në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe çrrënjësjes së varfërisë, në një mënyrë të koordinuar dhe efektive, duke përfshirë ndër të tjera, zbutje, adaptim, financim, transferim teknologjie dhe ndërtim kapacitetesh, si të jetë e përshtatshme. Këto qasje do të synojnë të:

- a) promovojnë ambicien e zbutjes dhe adaptimit;
- b) rrisin pjesëmarrjen e publikut dhe të sektorit privat në zbatimin e kontributeve të përcaktuara në nivel kombëtar; dhe
- c) mundësojnë mundësitë për koordinimin përmes instrumenteve dhe planifikimeve perkatëse institucionale.

9. Nëpërmjet kësaj përcaktohet një kuadër për qasjet jotregtare për zhvillimin e qëndrueshëm, për të promovuar qasjet jotregtare të referuara në paragrafin 8 të këtij neni.

Neni 7

1. Palët nëpërmjet kësaj krijojnë qëllimin global për adaptimin për të përmirësuar kapa-citetin adaptues, forcuar aftësitë rikuperuese dhe reduktuar vulnerabilitetin ndaj ndryshimit të klimës,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke siguruar një reagim adaptimi të përshtatshëm në kontekstin e qëllimit të temperaturës të referuar në nenin 2.

2. Palët pranojnë që adaptimi është një sfidë globale me të cilën përballen të gjithë me dimensione lokale, nënkombëtare, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe që është një komponent kryesor dhe sjell kontribut për reagim global afatgjatë ndaj ndryshimit të klimës për të mbrojtur njerëzit, jetesën dhe ekosistemet, duke marrë në konsideratë nevojat urgjente dhe të menjëhershme të atyre Palëve që janë vende në zhvillim, që janë veçanërisht vulnerabël ndaj efekteve negative të ndryshimit të klimës.

3. Përpjekjet për adaptim të Palëve, të cilat janë vende në zhvillim, do të njihen në përputhje me modalitetet që do të miratohen nga Konferenca e Palëve, që shërben si një takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit në sesionin e saj të parë.

4. Palët njohin që nevoja aktuale për adaptim është e rëndësishme dhe që nivele më të larta zbutjeje, mund të reduktojnë nevojën për përpjekje shtesë adaptimi dhe që nevoja më të mëdha adaptimi mund të përfshijnë kosto më të larta adaptimi.

5. Palët pranojnë që veprimet për adaptim duhet të ndjekin një qasje të drejtuar nga shteti, të përgjegjshme ndaj gjinisë, pjesëmarrëse dhe plotësisht transparente, duke marrë në konsideratë grupet vulnerabël, komunitetet dhe ekosistemet dhe duhet të bazohet në dhe të drejtohet nga shkenca më e mirë e disponueshme dhe, si të jetë e përshtatshme, njohuri tradicionale, njohuri për popullatat indigjene dhe sistemet lokale të njohurive, me qëllim integrimin e adaptimit në politikat dhe veprimet përkatëse socio-ekonomike dhe mjedisore, kur është e përshtatshme.

6. Palët njohin rëndësinë e mbështetjes dhe bashkëpunimin ndërkombëtar mbi përpjekjet e adaptimit dhe rëndësinë e marrjes në konsideratë të nevojave të Palëve të cilat janë vende në zhvillim, veçanërisht ato që janë vulnerabël ndaj efekteve negative të ndryshimit të klimës.

7. Palët duhet të forcojnë bashkëpunimin e tyre në përmirësimin e veprimeve për adaptimin, duke marrë në konsideratë Kuadrin e Adaptimit të Kankunit, duke përfshirë në lidhje me:

a) ndarjen e informacionit, praktikat e mira, përvojat dhe mësimet e marra, duke përfshirë, si të jetë e përshtatshme, pasi këto lidhen me shkencën, planifikim, politikat dhe zbatimin në lidhje me veprimet e adaptimit;

b) forcimin e planifikimeve institucionale, duke përfshirë ato sipas Konventës që i shërben kësaj Marrëveshjeje, për të mbështetur sintezën e informacionit dhe njohurive përkatëse dhe ofrimin e mbështetjes teknike dhe udhëzim për Palët;

c) forcimin e njohurive shkencore për klimën, duke përfshirë kërkimet, vëzhgimet sistematike të sistemit të klimës dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm, në një mënyrë që informon shërbimet klimatike dhe mbështet vendim-marrjen;

d) asistimin e Palëve të cilat janë vende në zhvillim, për identifikimin e praktikave efektive të adaptimit, nevojat e adaptimit, prioritetet, mbështetjen e ofruar dhe të marrë për veprimet dhe përpjekjet e adaptimit dhe sfidat dhe boshllëqet në një mënyrë që është në përputhje me inkurajimin e praktikave të mira;

e) përmirësimin e efektivitetit dhe qëndruesh-mërisë të veprimeve të adaptimit.

8. Organizatat dhe agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, inkurajohen që të mbështesin përpjekjet e Palëve për të zbatuar veprimet e referuara në paragrafin 7 të këtij neni, duke marrë në konsideratë dispozitat e paragrafit 5 të këtij neni.

9. Secila Palë, si të jetë e përshtatshme, do të angazhohet në proceset e planifikimit të adaptimit dhe të zbatimit të veprimeve, duke përfshirë zhvillimin apo përmirësimin e planeve, politikave dhe/ose kontributeve përkatëse, të cilat mund të përfshijnë:

a) zbatimin e veprimeve, sipërmarrjeve dhe/ ose përpjekjeve adaptuese;

b) procesin për të formuluar dhe zbatuar plane kombëtare adaptimi;

c) vlerësimin e ndikimeve të ndryshimit të klimës dhe vulnerabilitetet, me qëllim të formulimit të veprimeve prioritare të përcaktuara në nivel kombëtar, duke marrë në konsideratë personat, vendet dhe ekosistemet vulnerabël;

d) monitorimin dhe vlerësimin dhe duke mësuar nga planet, politikat, programet dhe veprimet

e adaptimit; dhe

e) ndërtimin e aftësive rikuperuese të siste-meve social-ekonomike dhe ekologjike, duke përfshirë nëpërmjet diversifikimit ekonomik dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

10. Secila Palë, si të jetë e përshtatshme, duhet të dorëzojë dhe të përditësojë periodikisht një komunikim adaptimi, i cili mund të përfshijë prioritetet e saj, zbatimin dhe nevojat e mbështetjes, planet dhe veprimet, pa krijuar ndonjë ngarkesë shtesë për Palët të cilat janë vende në zhvillim.

11. Komunikimi i adaptimit, i referuar në paragrafin 10 të këtij neni, si të jetë e përshtatshme, do të dorëzohet dhe do të përditësohet periodikisht, si një komponent i ose në lidhje me komunikimet ose dokumentet e tjera, duke përfshirë një plan adaptimi kombëtar, një kontri-but të përcaktuar kombëtar, siç është referuar në nenin 4, paragrafi 2, dhe/ose një komunikim kombëtar.

12. Komunikimet e adaptimit, të referuara në paragrafin 10 të këtij neni do të regjistrohen në një regjistër publik që mbahet nga sekretariati.

13. Mbështetja e vazhdueshme dhe e përmirësuar ndërkombëtare do t'u ofrohet Palëve, të cilat janë vende në zhvillim për zbatimin e paragrafëve 7, 9, 10 dhe 11 të këtij neni, në përputhje me dispozitat e neneve 9, 10 dhe 11.

14. Analiza globale e referuar në nenin 14, ndër të tjera, do të:

- a) njohë përpjekjet e adaptimit nga Palët të cilat janë vende në zhvillim;
- b) rrisë zbatimin e veprimeve të adaptimit duke marrë në konsideratë komunikimin e adaptimit të referuar në paragrafin 10 të këtij neni;
- c) Rishikojë mjaftueshmërinë dhe efektivitetin e adaptimit dhe mbështetjen e ofruar për adaptim; dhe
- d) Rishikojë progresin e përgjithshëm të bërë në arritjen e qëllimit global mbi adaptimin, e referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 8

1. Palët njohin rëndësinë e shmangies, minimizimit dhe trajtimit të humbjeve dhe dëmtimeve që shoqërohen me efektet negative të ndryshimit të klimës, duke përfshirë ngjarje ekstreme klimatike dhe ngjarje akute të ngadalta dhe rolin e zhvillimit të qëndrueshëm në reduk-timin e rrezikut të humbjeve dhe dëmtimeve.

2. Mekanizmi Ndërkombëtar i Varshavës për Humbje dhe Dëmtime të lidhura me Ndikimet e Ndryshimit të Klimës, do të jetë subjekt i autoritetit dhe udhëzimit të Konferencës së Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit dhe mund të përmirësohet dhe forcohet, siç është përcaktuar nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

3. Palët duhet të rrisin të kuptuarin, veprimin dhe mbështetjen, duke përfshirë nëpërmjet Mekanizmit Ndërkombëtar të Varshavës, si të jetë e përshtatshme, mbi baza bashkëpunuese dhe lehtësuese në lidhje me humbjet dhe dëmtimet që lidhen me efektet negative të ndryshimit të klimës.

4. Në përputhje me rrethanat, fushat e bashkëpunimit dhe lehtësimit për të përmirësuar kuptimin, veprimin dhe mbështetjen mund të përfshijnë:

- a) sistemet e paralajmërimit para kohe;
- b) gatishmëria në raste emergjencash;
- c) ngjarje akute të ngadalta;
- d) ngjarje që mund të përfshijnë humbje dhe dëmtime të pakthyeshme dhe të përhershme;
- e) vlerësim dhe menaxhim rreziku gjithë-përfshirës;
- f) shërbime të sigurimit të riskut, bashkimi i rreziqeve klimatike dhe zgjidhje të tjera sigurimi;
- g) humbje joekonomike;
- h) aftësi rikuperuese të komuniteteve, jetesës dhe ekosistemeve.

5. Mekanizmi Ndërkombëtar i Varshavës do të bashkëpunojë me organet ekzistuese dhe grupet e ekspertëve sipas Marrëveshjes, si edhe organizatat përkatëse dhe organet eksperte jashtë

Marrëveshjes.

Neni 9

1. Palët të cilat janë vende të zhvilluara do të ofrojnë burime financimi për të asistuar Palët të cilat janë vende në zhvillim në lidhje me zbutjen dhe adaptimin në vazhdimësi të detyrimeve të tyre sipas Konventës.

2. Palët e tjera inkurajohen që të ofrojnë ose të vazhdojnë që të ofrojnë një mbështetje të tillë vullnetare.

3. Si pjesë e një përpjekjeje globale, Palët të cilat janë shtete të zhvilluara, duhet të vazhdojnë të marrin drejtimin në mobilizimin e financimit të klimës nga një diversitet i gjerë burimesh, instrumentesh dhe kanalesh, duke theksuar rolin e rëndësishëm të fondeve publike, nëpërmjet një diversiteti veprimesh, duke përfshirë strategjitë e drejtuara nga shtetet dhe duke marrë në konsideratë nevojat dhe prioritetet e Palëve të cilat janë vende në zhvillim. Një mobilizim i tillë i financimit të klimës do të përfaqësojë një progres përtej përpjekjeve të mëparshme.

4. Sigurimi i burimeve financiare të përshka-llëzuara/në rritje duhet të synojë që të arrijë një ekuilibër ndërmjet adaptimit dhe zbutjes, duke marrë në konsideratë strategjitë e drejtuara nga shtetet dhe prioritetet dhe nevojat e Palëve të cilat janë vende në zhvillim, sidomos ato që janë veçanërisht vulnerabël ndaj efekteve negative të ndryshimit të klimës dhe kanë kufizime të rëndësishme kapaciteti, të tilla si vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet në zhvillim që janë ishuj të vegjël, duke marrë në konsideratë nevojën për burime publike dhe me baza grantesh për adaptim.

5. Palët të cilat janë vende në zhvillim do të komunikojnë çdo dy vjet informacion tregues sasior dhe cilësor, në lidhje me paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, si të jetë e aplikueshme, duke përfshirë, si të jetë e disponueshme, nivelet e projektuara të burimeve financiare publike, që do t'u ofrohen Palëve që janë vende në zhvillim. Palë të tjera që ofrojnë burime inkurajohen që të komunikojnë çdo dy vjet një informacion të tillë mbi baza vullnetare.

6. Analiza globale e referuar në nenin 14 do të marrë në konsideratë informacionin përkatës të ofruar nga Palët, të cilat janë vende të zhvilluara dhe/ose organet e Marrëveshjes, mbi përpjekjet në lidhje me financimin e klimës.

7. Palët që janë vende në zhvillim do të ofrojnë informacion transparent dhe të qëndrueshëm për mbështetjen për Palët të cilat janë vende në zhvillim, të siguruar dhe mobilizuara nëpërmjet ndërhyrjeve publike çdo dy vjet, në përputhje me modalitetet, procedurat dhe udhëzimet që do të miratohen nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, në sesionin e saj të parë, siç përcaktohet në nenin 13, paragrafi 13. Palët e tjera inkurajohen të veprojnë në këtë mënyrë.

8. Mekanizimi financiar i Konventës, duke përfshirë entitetet e saj operuese, do të shërbejë si një mekanizëm financiar i kësaj Marrëveshjeje.

9. Institucionet që i shërbejnë kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë entitetet operuese të Mekanizmit Financiar të Konventës, do të synojnë që të garantojnë akses efikas në burimet financiare, nëpërmjet procedurave të thjeshtuara të miratuara dhe mbështetje për gatishmërinë e përmirësuar për Palët të cilat janë vende në zhvillim, në veçanti për vendet më pak të zhvilluara dhe shtete në zhvillim që janë ishuj të vegjël (SIDS), në kontekstin e strategjive dhe planeve të tyre kombëtare për klimën.

Neni 10

1. Palët ndajnë një vizion afatgjatë mbi rëndësinë e realizimit të plotë të zhvillimit dhe transferimit të teknologjisë, në mënyrë që të përmirësojnë aftësitë rikuperuese ndaj ndryshimit të klimës dhe për të reduktuar emetimet e gazit serrë.

2. Palët, duke theksuar rëndësinë e tekno-logjisë për zbatimin e veprimeve zbutëse dhe adaptuese, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe duke njohur përpjekjet ekzistuese për vendosjen dhe shpërndarjen e teknologjisë, do të forcojnë masat bashkëpunuese mbi zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë.

3. Mekanizmi i teknologjisë i krijuar sipas Konventës do t'i shërbejë kësaj Marrëveshjeje.

4. Nëpërmjet kësaj krijohet një kuadër teknologjie për të siguruar udhëzime gjithë-përfshirëse për punën e Mekanizmit të Teknologjisë, në promovimin dhe lehtësimin e veprimeve të përmirësuara për zhvillim dhe transferimin e teknologjisë, në mënyrë që të mbështesë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, në zbatim të vizionit afatgjatë të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

5. Përsheptimi, inkurajimi dhe mundësimi i inovacionit është kritik për një reagim global afatgjatë ndaj ndryshimit të klimës dhe promovimit të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Përpjekje të tilla, si të jetë e përshtatshme, do të jenë të duhura, të mbështetura, duke përfshirë mekanizmin e teknologjisë dhe, nëpërmjet mjeteve financiare nga Mekanizmi Financiar i Konventës, për qasje bashkë-punuese për kërkim dhe zhvillim dhe duke lehtësuar aksesin në teknologji, në veçanti në fazat e hershme të ciklit të teknologjisë, për Palët të cilat janë vende në zhvillim.

6. Mbështetja, duke përfshirë mbështetje financiare, do t'u ofrohet Palëve të cilat janë vende në zhvillim, për zbatimin e këtij neni, duke përfshirë forcimin e veprimeve bashkëpunuese mbi zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë në faza të ndryshme të ciklit të teknologjisë, me qëllim që të arrihet një balancë ndërmjet mbështetjes për zbutje dhe adaptim. Analiza globale, e referuar në nenin 14, do të marrë në konsideratë informacionin e disponueshëm mbi përpjekjet në lidhje me mbështetjen mbi zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë për Palët të cilat janë vende në zhvillim.

Neni 11

1. Ndërtimi i kapaciteteve, sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të përmirësojë kapacitetin dhe mundësinë e Palëve të cilat janë vende në zhvillim, në veçanti shtetet me kapacitete më të ulëta, të tilla si vendet më pak të zhvilluara dhe ato që janë në veçanti shtetet me kapacitete më të ulëta, të tilla si vendet më pak të zhvilluara dhe ato që janë veçanërisht vulnerabël ndaj efekteve negative nga ndryshimi i klimës, të tilla si shtetet në zhvillim që janë ishuj të vegjël (SIDS), për të marrë veprime efektive për ndryshimin e klimës, duke përfshirë, ndër të tjera, për të zbatuar veprimet e adaptimit dhe zbutjes dhe duhet të lehtësojë zhvillimin e teknologjisë, përhapjen dhe vendosjen, aksesin në financimin e klimës, aspektet përkatëse të edukimit, trajnimit dhe ndërgjegjësimit të publikut dhe komunikimin transparent, në kohë dhe të saktë të informacionit.

2. Ndërtimi i kapaciteteve duhet të drejtohet nga shteti, bazuar në dhe reagues ndaj nevojave kombëtare dhe të nxisë pronësi shteti të Palëve, në veçanti, për Palët të cilat janë vende në zhvillim, duke përfshirë nivelet kombëtare, nënkombëtare dhe lokale. Ndërtimi i kapaciteteve duhet të drejtohet nga mësimet e marra, duke përfshirë ato nga aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve sipas Konventës dhe duhet të jetë një proces efektiv përsëritës që është pjesëmarrës, ndërsektorial dhe reagues/i përgjegjshëm ndaj gjinisë.

3. Të gjitha Palët duhet të bashkëpunojnë për të përmirësuar kapacitetin e Palëve të cilat janë vende në zhvillim, për të zbatuar këtë Marrëveshje. Palët, që janë vende të zhvilluara, duhet të përmirësojnë mbështetjen për masat e ndërtimit të kapaciteteve të Palët të cilat janë vende në zhvillim.

4. Të gjitha Palët që përmirësojnë kapacitetin e Palëve të cilat janë vende në zhvillim, për të zbatuar këtë Marrëveshje, duke përfshirë nëpërmjet qasjeve rajonale, bilaterale dhe multilaterale, do të komunikojnë rregullisht mbi këto veprime ose masa për ndërtimin e kapaciteteve. Palët, që janë vende në zhvillim, duhet të komunikojnë rregullisht progresin e bërë mbi zbatimin e planeve, politikave apo masave të ndërtimit të kapaciteteve për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5. Aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve do të përmirësohen nëpërmjet marrëveshjeve të duhura institucionale, për të mbështetur zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë marrëveshjet e duhura institucionale të krijuara sipas Konventës që i shërben kësaj Marrëveshjeje. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, në sesionin e saj të parë, do të marrë në konsideratë dhe do të miratojë një vendim mbi marrëveshjet institucionale fillestare për ndërtimin e kapaciteteve.

Neni 12

Palët do të bashkëpunojnë në marrjen e masave, si të jetë e përshtatshme, për të përmirësuar edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e publikut, pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin e publikut në informacion, për ndryshim e klimës, duke njohur rëndësinë e këtyre hapave në lidhje me përmirësimin e veprimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

1. Në mënyrë që të ndërtohet besim dhe mirëbesim reciprok dhe për të promovuar zbatim efektiv, nëpërmjet kësaj krijohet një kuadër transparence i përmirësuar për veprim dhe mbështetje, me fleksibilitet të ndërtuar, i cili merr në konsideratë kapacitetet e ndryshme të Palëve dhe bazohet në përvojën kolektive.

2. Kuadri i transparencës do të ofrojë fleksibilitet në zbatimin e dispozitave të këtij neni, për ato Palë që janë vende në zhvillim, që kanë nevojë në bazë të kapaciteteve të tyre. Modalitetet, procedurat dhe udhëzimet e referuara në paragrafin 13 të këtij neni do të reflektojnë një fleksibilitet të tillë.

3. Kuadri i transparencës do të bazohet në dhe do të përmirësojë marrëveshjet e transparencës sipas Konventës, duke njohur rrethanat e veçanta të vendeve më pak të zhvilluara dhe shtetet në zhvillim që janë ishuj të vegjël (SIDS) dhe të zbatohet në një mënyrë lehtësuese, jondërrhyrëse dhe jondëshkuuese, duke respektuar sovranitetin kombëtar dhe duke evituar vendosjen e ngarkesave të panevojshme mbi Palët.

4. Marrëveshjet e transparencës sipas Konventës, duke përfshirë komunikimet kombëtare, raportet dyvjeçare dhe raportet e përditësuara dyvjeçare, vlerësimin dhe rishikimin ndër-kombëtar dhe konsultimin dhe analizimin ndër-kombëtar, do të përbëjnë pjesë të përvojës të hartuar mbi zhvillimin e modaliteteve, procedurave dhe udhëzimeve, sipas paragrafit 13 të këtij neni.

5. Qëllimi i kuadrit për transparencë të veprimeve është që të ofrojë një kuptim të qartë të veprimeve për ndryshimin e klimës në bazë të objektivit të Konventës, siç është përcaktuar në nenin 2 të saj, duke përfshirë qartësi dhe gjurmim të progresit drejt arritjes së kontributeve individuale të përcaktuara në nivel kombëtar të Palëve, sipas nenit 4 dhe veprimet e adaptimit të Palëve sipas nenit 7, duke përfshirë praktikatat e mira, prioritetet, nevojat dhe boshllëqet për të informuar analizën globale, sipas nenit 14.

6. Qëllimi i kuadrit për transparencë të mbështetjes është që të ofrojë qartësi mbi mbështetjen e ofruar dhe të marrë nga Palët individuale përkatëse në kontekstin e veprimeve për ndryshimin e klimës sipas neneve 4, 7, 10 dhe 11 dhe sa më shumë që të jetë e mundur, të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të plotë të mbështetjes financiare të grumbulluar që është ofruar, për të informuar analizën globale sipas nenit 14.

7. Secila Palë do të ofrojë rregullisht informacionin e mëposhtëm:

a) një raport-inventar kombëtar të emetimeve antropogjene nga burimet dhe heqjet nga vaskat e gazit serrë, të përgatitur duke përdorur mëto-dologjitë e praktikave të mira të pranuar nga Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimin e Klimës dhe për të cilin është rënë dakord nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit;

b) informacion të nevojshëm për të gjurmuar progresin e bërë në zbatimin dhe arritjen e kontributit të tyre të përcaktuar në nivel kombëtar sipas nenit 4.

8. Secila Palë duhet, gjithashtu, të ofrojë informacion në lidhje me ndikimet e ndryshimit të klimës dhe adaptimit sipas nenit 7, si të jetë e përshtatshme.

9. Palët të cilat janë vende të zhvilluara dhe Palë të tjera të cilat ofrojnë mbështetje, duhet të ofrojnë informacion mbi mbështetjen financiare, transferimin e teknologjisë dhe ndërtimin e kapaciteteve që u është ofruar Palëve të cilat janë vende në zhvillim sipas nenit 9, 10 dhe 11.

10. Palët të cilat janë vende në zhvillim duhet të ofrojnë informacion mbi mbështetjen financiar, për transferimin e teknologjisë dhe për ndërtimin e kapaciteteve që ato kanë nevojë dhe që kanë marrë sipas neneve 9, 10 dhe 11.

11. Informacioni i dorëzuar nga secila Palë sipas paragrafëve 7 deri 9 të këtij neni, do t'i

nënshtrohet një rishikimi ekspert teknik, në përputhje me vendimin 1/CP.21. Për ato Palë të cilat janë vende në zhvillim, që kanë nevojë për të, në bazë të kapaciteteve të tyre, procesi i rishikimit do të përfshijë asistencë në identifikimin e nevojave për ndërtimin e kapaciteteve. Për më tepër, secila Palë do të marrë pjesë në një konsideratë progresi lehtësuese multilaterale, në lidhje me përpjekjet sipas nenit 9 dhe zbatimin e saj përkatës dhe arritjen e kontributit të saj të përcaktuar në nivel kombëtar.

12. Rishikimi ekspert teknik, sipas këtij paragrafi, do të konsistojë një konsideratë të mbështetjes të ofruar për Palën, si të jetë relevante dhe zbatimin e saj dhe arritjen e kontributit të saj të përcaktuar në nivel kombëtar. Rishikimi do të identifikojë, gjithashtu, fushat e përmirësimit për Palën dhe do të përfshijë një rishikim të përputhshmërisë së informacionit me modalitetet, procedurat dhe udhëzimet e referuara në paragrafin 13 të këtij neni, duke marrë në konsideratë fleksibilitetin e dhënë Palës sipas paragrafit 2 të këtij neni. Rishikimi do t'u kushtojë vëmendje të veçantë aftësive përkatëse kombëtare dhe rrethanave të Palëve të cilat janë shtete në zhvillim.

13. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, në sesionin e saj të parë, duke ndërtuar mbi përvojën nga marrëveshjet në lidhje me transparencën sipas Konventës dhe duke përpunuar mbi dispozitat e këtij neni, do të miratojë modalitete, procedurat dhe udhëzimet, si të jetë e përshtatshme, për transparencën e veprimeve dhe mbështetjes.

14. Vendeve në zhvillim do t'u ofrohet mbështetje për zbatimin e këtij neni.

15. Do të ofrohet, gjithashtu, mbështetje për ndërtimin e kapacitetit në lidhje me transparencën e Palëve, të cilat janë vende në zhvillim mbi baza të vazhdueshme.

Neni 14

1. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të analizojë periodikisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për të vlerësuar progresin kolektiv drejt arritjes së qëllimit të kësaj Marrëveshjeje dhe qëllimet e saj afatgjata (e referuar si “analiza globale”). Do të veprojë kështu në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe lehtësuese, duke marrë në konsideratë zbutjen, adaptimin dhe mjetet e zbatimit dhe mbështetjen dhe në bazë të barazisë dhe shkencës më të mirë të disponueshme.

2. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të ndërmarrë analizën e parë globale në vitin 2023 dhe më pas çdo pesë vjet, me përjashtim nëse vendoset ndryshe nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

3. Rezultati i analizës globale do të informojë Palët në përditësim dhe përmirësim, në një mënyrë të përcaktuar në nivel kombëtar, vepri-met e tyre dhe mbështetjen në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, si edhe në përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për veprime klimatike.

Neni 15

1. Nëpërmjet kësaj themelohet një mekanizëm për të lehtësuar zbatimin dhe për të promovuar përputhshmëri me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Mekanizmi i referuar në paragrafin 1 të këtij neni do të përfshijë një komitet që do të bazohet në ekspertë dhe do të jetë lehtësues në natyrë dhe në funksion, në një mënyrë që të jetë transparent, i pakundërshtueshëm dhe jondëshkues. Komiteti do t'u kushtojë vëmendje të veçantë aftësive kombëtare përkatëse dhe rrethanave të Palëve.

3. Komiteti do të operojë sipas modaliteteve dhe procedurave të miratuara nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, në sesionin e saj të parë dhe i raporton çdo vit Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

Neni 16

1. Konferenca e Palëve, organi suprem i Konventës, do të shërbejë si takimi i Palëve për këtë Marrëveshje.

2. Palët e Konventës, të cilat nuk janë Palë të kësaj Marrëveshjeje, mund të marrin pjesë si vëzhgues në procedurat e çdo sesioni të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për këtë Marrëveshje. Kur Konferenca e Palëve shërben si takim i Palëve për këtë Marrëveshje, vendimet për këtë Marrëveshje do të merren vetëm nga ato që janë Palë e kësaj Marrëveshjeje.

3. Kur Konferenca e Palëve shërben si takim i Palëve për këtë Marrëveshje, çdo anëtar i Byrosë së Konferencës së Palëve që përfaqëson një Palë në Konventë, por në atë moment nuk është një Palë e kësaj Marrëveshjeje, do të zëvendësohet nga një anëtar shtesë që do të zgjidhet nga dhe ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje.

4. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të mbajë nën shqyrtim të rregullt zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe brenda mandatit të saj do të marrë vendimet e nevojshme për të nxitur zbatimin e saj efektiv. Ajo do të kryejë funksionet që i janë caktuar nga kjo Marrëveshje dhe do të:

a) themelojë organe ndihmëse të tilla si të jetë e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) ushtrojë funksione të tjera, siç mund të kërkohen për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5. Rregullat e procedurës së Konferencës së Palëve dhe procedurat financiare të zbatuara sipas Konventës do të zbatohen *mutatis mutandis*, sipas kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim, siç mund të jetë vendosur ndryshe, me konsensus nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

6. Sesioni i parë i Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të mbledhet nga sekretariati në bashkëpunim me sesionin e parë të Konferencës së Palëve, që është planifikuar pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Sesionet e zakonshme vijuese të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të mbahen në bashkëpunim/ kombinim me sesionet e zakonshme të Konferencës së Palëve, me përjashtim nëse vendoset ndryshe nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim për Marrëveshjen e Parisit.

7. Sesione të jashtëzakonshme të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të mbahen në momente të tjera, siç mund të shikohet e nevojshme nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit ose me kërkesë me shkrim nga ndonjëra nga Palët, parashikuar që, brenda gjashtë muajve që është komunikuar kërkesa te Palët nga sekretariati, ajo mbështetet nga të paktën një e treta e Palëve.

8. Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si edhe çdo shtet anëtar prej tyre ose vëzhgues të tyre që nuk janë Palë me Konventën, mund të përfaqësohen në sesionet e Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, si vëzhgues. Çdo organ apo agjenci, qoftë kombëtare apo ndërkombëtare, qeveritare apo joqeveritare, e cila është e kualifikuar në çështjet e mbuluara nga kjo Marrëveshje dhe që ka informuar sekretariatit për dëshirën e saj për t'u përfaqësuar në një sesion të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, si një vëzhgues, mund të jetë e tillë me përjashtim nëse të paktën një e treta e Palëve të pranishme e kundërshtojnë. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve do të jenë subjekt rregullave të procedurës së referuar në paragrafin 5 të këtij neni.

Neni 17

1. Sekretariati i themeluar nga neni 8 i Konventës do të shërbejë si sekretariat i kësaj Marrëveshjeje.

2. Neni 8, paragrafi 2 i Konventës, mbi funksionet e sekretariatit dhe neni 8, paragrafi 3 i Konventës mbi marrëveshjet e bëra për funksionimin e sekretariatit, do të zbatohet *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje. Sekretariati, për më tepër, do të ushtrojë funksionet e përcaktuara atij sipas Marrëveshjes dhe nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

1. Organi Ndhmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organi Ndhmës për Zbatimin, të themeluar nga nenet 9 dhe 10 të Konventës do të shërbejnë përkatësisht si Organi Ndhmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organi Ndhmës për Zbatim të kësaj Marrëveshjeje. Dispozitat e Konventës që lidhen me funksionimin e këtyre dy organeve do të zbatohen *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje. Sesionet e takimit të Organit Ndhmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organit Ndhmës për Zbatim të kësaj Marrëveshjeje, do të mbahen në bashkëpunim/kombinim me takimet, përkatësisht, Organi Ndhmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organi Ndhmës për Zbatim të Konventës.

2. Palët e Konventës që nuk janë Palë e kësaj Marrëveshjeje, mund të marrin pjesë si vëzhgues në procedurat e çdo sesiioni të organeve ndihmëse. Kur organet ndihmëse shërbejnë si organet ndihmëse të kësaj Marrëveshjeje, vendimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të merren vetëm nga ato që janë Palë në këtë Marrëveshje.

3. Kur organet ndihmëse, të themeluara nga nenet 9 dhe 10 të Konventës, ushtrojnë funksionet e tyre në lidhje me çështjet që lidhen me këtë Marrëveshje, çdo anëtar i byrove të atyre organeve ndihmëse që përfaqësojnë një Palë në Konventë, por në atë moment jo Palë e kësaj Marrëveshjeje, do të zëvendësohet nga një anëtar shtesë që do të zgjidhet nga dhe ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 19

1. Organet ndihmëse ose marrëveshje të tjera institucionale, të themeluara nga dhe sipas Konventës, të ndryshme nga ato të referuara në këtë Marrëveshje, do t'i shërbejnë kësaj Marrëveshjeje me vendim të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve të Marrëveshjes së Parisit. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve të Marrëveshjes së Parisit, do të specifikojë funksionet e ushtruara nga këto organe apo marrëveshje.

2. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, mund të ofrojë udhëzim të mëtijshëm për organe të tilla ndihmëse dhe marrëveshje institucionale.

Neni 20

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim dhe subjekt për ratifikim, pranim dhe miratim nga shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik të cilat janë Palë të Konventës. Ajo do të jetë e hapur për nënshkrim në Zyrat Qendrore të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork nga data 22 prill 2016 deri më 21 prill 2017. Më pas, kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për aderim nga dita pas datës në të cilën është mbyllur për nënshkrim. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit do të depozitohen te Depozitari.

2. Çdo organizatë rajonale e integritit ekonomik që bëhet Palë e kësaj Marrëveshjeje, ku asnjë nga shtetet e tyre anëtare nuk është Palë, do të jetë e detyruar t'u përmbahet të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje. Në rastin e organizatave rajonale të integritit ekonomik, ku një ose më shumë shtete anëtare janë Palë e kësaj Marrëveshjeje, organizata dhe shteti i saj anëtar do të vendosin mbi përgjegjësitë e tyre përkatëse për përmbushjen e detyrimeve të tyre, sipas kësaj Marrëveshjeje. Në raste të tilla, organizata dhe shtetet anëtare nuk do të jenë të autorizuar të ushtrojnë të drejta njëkohësisht sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Në instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, organizatat rajonale të integritit ekonomik do të deklarojnë shtrirjen e kompetencave të tyre në lidhje me çështjet e rregulluara nga kjo Marrëveshje. Këto organizata do të informojnë, gjithashtu, Depozitarin, i cili nga ana e tij do të informojë Palët për çdo modifikim thelbësor në shtrirjen e kompetencave të tyre.

Neni 21

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës në të cilën të paktën 55 Palë të Konventës, që përbëjnë në total të paktën një përllogaritje prej 55 për qind të emetimeve globale të gazit serrë kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit.

2. Vetëm për qëllimin e kufizuar të paragrafit 1 të këtij neni, “emetimet totale globale të gazit serrë” nënkupton shumën/sasinë, më të fundit të përditësuar, të komunikuar më ose përpara datës së miratimit të kësaj Marrëveshjeje nga Palët e Konventës.

3. Për çdo shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik që ratifikon, pranon apo miraton këtë Marrëveshje ose aderon në të pasi janë përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni për hyrjen në fuqi, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga ky shtet apo organizatë rajonale të integritit ekonomik të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

4. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale të integritit ekonomik nuk do të llogaritet si shtesë e atyre të depozituara nga shteti i saj anëtar.

Neni 22

Dispozitat e nenit 15 të Konventës, mbi miratimin e amendamenteve të Konventës, do të zbatohen *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje.

Neni 23

1. Dispozitat e nenit 16 të Konventës, mbi miratimin dhe amendimin e anekseve të Konventës, do të zbatohen *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje.

2. Aneksat e kësaj Marrëveshjeje do të përbëjnë pjesë integrale të saj dhe me përjashtim nëse është parashikuar shprehimisht ndryshe, një referencë ndaj kësaj Marrëveshjeje përbën në të njëjtën kohë një referencë për secilin nga anekset e saj. Këto anekse do të jenë të kufizuara në listat, formatet dhe çdo material tjetër të një natyre përshkuese që është e një karakteri shkencor, teknik, procedural ose administrativ.

Neni 24

Dispozitat e nenit 14 të Konventës mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të zbatohen *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje.

Neni 25

1. Secila Palë do të ketë një votë, me përjashtim kur është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Organizatat rajonale të integritit ekonomik, në çështjet brenda kompetencave të tyre, do të ushtrojnë të drejtën për të votuar me një numër votash të barabartë me ato të shteteve të tyre anëtare që janë Palë të kësaj Marrëveshjeje. Një organizatë e tillë nuk do të ushtrojë të drejtën për të votuar nëse shteti i saj anëtar ushtron të drejtën e tij dhe anasjelltas.

Neni 26

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë Depozitari i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 27

Nuk mund të bëhet asnjë rezervë ndaj kësaj Marrëveshjeje.

Neni 28

1. Në çdo kohë, pas tri viteve nga data në të cilën kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi për një Palë, ajo Palë mund të tërhiqet nga Marrëveshja duke dhënë një njoftim me shkrim te Depozitari.

2. Çdo tërheqje e tillë do të marrë efekt me skadimin e një viti, nga data e marrjes së njoftimit të tërheqjes nga Depozitari ose në datën e kësaj letre, siç mund të jetë specifikuar në njoftimin për tërheqje.

3. Çdo Palë që tërhiqet nga Konventa do të konsiderohet që është tërhequr, gjithashtu, edhe nga Marrëveshja.

Neni 29

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje, tekstet e së cilës në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle janë njëloj autentike, do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve

të Bashkuara.

Bërë në Paris, sot, në ditën e dymbëdhjetë të dhjetorit, dy mijë e pesëmbëdhjetë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.